



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:169954

Datë: 23.11.2022

Numri i dokumentit: 03678946

PKR Nr. 152/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Krimeve të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.N. nga fsh. K. e Ulët, K. D., për shkak të kryerjes së veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda nen shenjen PP/I Nr. 227/22 dt. 19.08.2022, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar me dt. 23.11.2022, në prezencë të Prokurores së shtetit Valbona Disha Haxhosaj dhe të akuzuarit M.N., të njëjtën ditë e mori dhe publikisht shpalli, dhe po ashtu të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.N., i biri i M. dhe nënës S. e gjinisë M., i lindur me dt. ... në fsh. K. e U. K. D., me banim të përkohshëm ne Gj., i martuar, ka te kryer shkollën e mesme, me profesion - gastronom, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal, posedon tel. ...-...-..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i pa dënuar, **gjendet në liri**,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Më parë e gjerë me datën 15.08.2021 rreth orës 22:45 në K., pikërisht në „R. D.”, në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armën dhe atë revolen me G. B. , kalibër .mmK-made in I, se bashku me një karikator dhe 6 cop fishek, në atë mënyrë që policia me te pranuar informatë se në Restorant „D.” ka te shtëna nga arma e zjarrit, të njëjtit shkojnë ne vendin e ngjarjes dhe ne kontaktin e pare me te pandehurin i njëjti pranon se ka ne posedim armen me gaz dhe se me te njëjtën ne shenje gëzimi kishte shtëne ne ajër,

- me çka ka kryer veprën penale “**Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21 par. 2 38, 39 par.1 nënpar.1.3, 43 par.1, 3, 69 par.1 pika 3.6 dhe 3.7, 70, 366 par.1 dhe par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 360, 365, 366, 453 par.3 të KPPRK-së, të njëjtit e:

G J Y K O N

- I. Me dënim me gjobë në shumë prej dyqind (200) euro, e të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaje në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi, duke i llogaritur për një ditë burgimi shumë nënjzetë (20) euro.
- III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumë prej tridhjetë (30) € si dhe shumen prej 50 (pesëdhjete) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Në kuptim të nenit 366 par. 3, të KPRK-së, të pandehurit M.N. i shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

KONFISKOHET një (1) revole me Gas – A. B., kalibër .mm – M. in I., një (1) karikator si dhe gjashtë (6) copë gëzhoja të kalibrit 8 mm, dhe të njëjtat **URDHËROHET** që pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit të **SHKATËRROHEN**.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 227/22 dt. 19.08.2022 kundër të pandehurit M.N. nga fsh. K. e Ulët, K. D., për shkak të veprës penale “**Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve**” nga neni 366 par.1 të KPPK-së.

Kjo lëndë fillimisht ka qenë të gjyqtarja tjetër, mirëpo meqenëse e njëjta ka qenë në pushim vjetor jashtë vendit, dhe meqenëse i pandehuri vullnetarisht është paraqitur në gjykatë duke kërkuar që mundësisht të mbahet seanca, pasi që jeton në botën e jashtme, respektivisht në Gjermani dhe se duhet të udhëtoje, kjo lëndë i është rikaktuar Kryetarit të trupit gjykues për të vepruar në këtë çështje penale.

Si rrjedhojë e kësaj, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 23.11.2022, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë Valbona Disha Haxhosaj dhe i pandehuri M.N..

Pas njoftimit të të pandehurit lidhur me të drejtat e tij nga neni 246 par. 1 të KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar se e ka kuptuar të drejtat e tij dhe se mbrojtjen do ta jep personalisht, nuk ka nevojë për mbrojtës.

Pas konstatimit të aktakuzës nën shenjen PP/I Nr. 227/22 si e lexuar, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit si dhe të pandehurit M.N., gjykata është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë, kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë, është penduar shumë dhe ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërit veprime të tilla në të ardhmen.

Prokurorja e shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit M.N. ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse i plotëson kushtet ligjorë dhe po ashtu ka mbështetje në shkresat e lëndës, dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *raportit të oficerit A. A. me nr. të rastit 2022-...-... dt. 15.08.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dt.15.08.2022, fotot e armës, leja e armës e lëshuar nga autoritetet Gj., procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin M.N. në Polici me dt. 15.08.2022, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të pandehurit në Prokurori me dt. 19.08.2022, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurorja e shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit propozoj gjykatës si rrethana lehtësuese të vlerëson pranimin e fajësisë, sinqeritetin e tij, gatishmërinë e të pandehurit që të bashkëpunojë me organet e drejtësisë e i cili për këtë rast që dy here është duke ardhur nga Shteti i Gjermanisë sikur që ka pas edhe shpenzime për ardhje, kurse rrethana renduese Prokuroria në rastin konkret nuk ka gjetur, andaj i propozoj gjykatës që të pandehurin të shpall fajtor të dënon sipas ligjit, si dhe të obligon në paguarjen e shpenzimeve procedurale, dhe në rastin konkret të njëjtit të shqiptojë dënim duke aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimeve të nenit 71 dhe 72 të KPRK-së. Po ashtu shtoj se në rastin konkret heq dore nga e drejta për ushtrimin e ankesës.*

I pandehuri M.N. ka deklaruar se: *i propozojë gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh rrethanat lehtësuese të potencuara nga Prokurorja e Shtetit, mua me vjen keq që ka ndodhur ky rast, jam penduar shumë, kjo është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe i premtoj gjykatës së nuk do ta përsëris veprime të tilla, kërkoj nga gjykata që mundësisht të me shqiptojë një dënim sa më të butë. Po ashtu shtoj se në rastin konkret heq dore nga e drejta për ushtrimin e ankesës.*

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPPK-së.**

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe renduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e Prokurorit të Shtetit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri në të gjitha fazat si dhe në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, sinqeritetin e tij, gatishmërinë për ta bashkëpunuar me organet e drejtësisë, pendimin e tij për veprën e kryer, mosednueshmerine e tij të mëparshme, ndërkaq nga rrethanat renduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me gjobe u morr konform nenit 40 par. 1 pika 1.3, nenit 43 dhe nenit 366 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim burgimi do merret në aplikim të nenit 43 par.3, të KPRK-së, në rast se i pandehuri nuk e paguan, refuzon apo dështon ta paguaj në dënimin me gjobë e shqiptuar si në piken I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Vendimi për konfiskim të armës dhe municionit, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit Nr. 05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.152/22 dt. 23.11.2022

Zyrtari ligjor
Alan Taranish

Kryetari i trupit gjykues,
Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.